

Data ___/08/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Infrastruktura e rrjetit, 32424000-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,000,000 (dhjetë milion) Lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti kontraktor Tirana Parking, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit. Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40%, të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe pikës 4, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet/shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi/shërbimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Institucioni dhe llojit të mallit/shërbimit objekt prokurimi, i rëndësishëm për ushtrimin e funksionve të punonjësve të Institucionit, me qëllim krijimin e marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme është kërkuar marzhin e vlerës së parashikuar sipas Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar).

2.3.2. Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardeve ISO:

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit
- c) Standardin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi 2.3.2/a, 2.3.2/b dhe 2.3.2/c:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Çertifikimet ISO, janë çertifikata që i’u akordohen kompanive/organizatave të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Argumentimi për kërkesë për paraqitjen e Certifikimit ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë; parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (*për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative*), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Argumentimi për kërkesën për paraqitjen e Certifikimit ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit; Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Sistemi i menaxhimit të shërbimit është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Sistemi i menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre. Kërkesat përfshijnë projektimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit, nëpërmjet sigurisë së nevojshme për ecurinë e punës së AK. Projekti kërkon realizim brenda një periudhe kohore të parapërcaktuar, relativisht të shkurtër dhe shërbime intensive që duhen të jenë detajisht të monitoruara. Ky standard/certifikatë ose ekuivalenti i saj, i siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Argumentimi për kërkesën për paraqitjen e Certifikimit ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit; Është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon Autoriteti Kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- Respektimin e kërkesave rregullatore në lidhje me sigurinë e informacionit, gjë që mund të zvogëlojë rrezikun e veprimeve jo ligjore.
 - Identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë e informacionit, gjë që siguron që ofertuesi i shërbimeve/mallarave T.I.K, të shmangin rreziqet e mundshme dhe të përmirësojnë qëndrueshmërinë e përgjithshme të sistemit.
 - Eliminonjë proceset e panevojshme, të reduktojnë gabimet dhe të përmirësojnë performancën e përgjithshme, duke çuar në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit.
-

Në kushtet që instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme të sistemit, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit, si rrjedhojë çertifikimi ISO 27001, është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen. Të gjitha të dhënat që do të trajtohen dhe do të ruhen në sistem, përfshirë edhe ato të konfigurimit si dhe të përdoruesve të sistemit janë të ndjeshme. Aksesin në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit dhe aksesin në informacion për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi monitorues i kontratës, megjithatë çertifikimi ISO 27001 për operatorin ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë:

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse në DST. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

[..Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se Operatorët Ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie..]

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se objekt-prokurimi është një projekt i teknologjisë së informacionit (T.I.K) nisur nga termit e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar ose/dhe të çertifikuar në fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

- a. një punonjës të çertifikuar si specialist në programimin në HTML5 me JavaScript dhe CSS3 ose ekuivalente.

Argumentim: HTML5 dhe JavaScript janë teknologjitë kryesore mbi të cilat është zhvilluar ndërfaqja e përdoruesit e platformës për metodat alternative të pagesave të parkimit.

Përdorimi i JavaScript për krijimin e ndërfaqeve të përdoruesve mundëson funksionalitete komplekse, si validimi në kohë reale i formularëve dhe menaxhimi i abonimeve. Për më tepër, zhvillimi i moduleve të reja në JavaScript lejon integrimin e tyre me sistemin ekzistues backend përmes API-ve, duke mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave në mënyrë efikase.

Kërkesa që OE të ketë në stafin e tij një specialist me njohuri në CSS3 dhe JavaScript i siguron AK-së që OE ka staf të aftë për të krijuar ndërveprime të avancuara, si animacionet, modalet dhe njoftimet push. Këto ndërveprime përshtaten automatikisht me madhësitë e ekranit të pajisjeve të ndryshme, për garantuar një eksperiencë optimale për përdoruesit që përdorin smartfonë dhe tableta.

Për më tepër, mbajtja e kualifikimit të kërkuar nga specialisti siguron AK-në se ai do të jetë në gjendje të implementojë praktika të sigurta në kodim, duke mbrojtur të dhënat e përdoruesve dhe duke garantuar integritetin e sistemit. Kjo përfshin masat e sigurisë që janë të nevojshme për të mbrojtur platformën nga sulmet e mundshme dhe për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave të përdoruesve.

- b. dy punonjës të certifikuar si zhvillues të Java/ PHP ose ekuivalente.

Argumentim: Zhvilluesit e certifikuar në Java, PHP, ose gjuhë ekuivalente ofrojnë garanci të njohurive të thelluara dhe përvojës së avancuar në programimin backend, çka është thelbësore për zhvillimin e moduleve të reja në platformën për metodat alternative të pagesave të parkimit. Këta zhvillues do të sigurojnë që kodimi të jetë i saktë, i optimizuar dhe që komponentët e ndryshëm të sistemit të bashkëveprojnë në mënyrë të integruar dhe funksionale. Zhvillimi i moduleve të reja për shërbimet e parkimit, si abonimet, shërbimet për rezidentët dhe taksitë, kërkon një zhvillim kompleks dhe një kuptim të avancuar të strukturës ekzistuese të platformës. Kjo përfshin aftësinë për të implementuar funksionalitete të reja pa shkaktuar ndërprerje ose probleme në sistem.

Një nga risqet kryesore të identifikuara gjatë zhvillimit të projekteve të ngjashme është mundësia e gabimeve në kodim, të cilat mund të ndikojnë në ngadalësimin apo keqfunksionimin e sistemit. Për të garantuar funksionalitetin e plotë të sistemit, është thelbësore që operatori ekonomik të demonstrojë disponimin e dy zhvilluesve me përvojë dhe të certifikuar, të cilët do të sigurojnë që projekti të përmbushet brenda buxhetit dhe afatit të përcaktuar në kontratë. Certifikimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) garanton që zhvilluesit kanë kuptueshmëri dhe përvojë të standardeve dhe praktikave më të mira në programimin backend. Kjo siguron që modulet e zhvilluara të jenë në përputhje me rregulloret e teknologjisë së aplikuar.

- c. një ekspert i certifikuar në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës.

Argumentim: Në fazën fillestare të zhvillimit të moduleve të reja, është e domosdoshme që të dhënat të analizohen në mënyrë të detajuar. Një ekspert i certifikuar në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës do të përdorë metodologji të avancuara për të analizuar modelet e përdorimit, për të identifikuar trendet dhe për të bërë parashikime të bazuara në të dhëna.

Kjo qasje është e rëndësishme për hartimin e arkitekturës së moduleve të personalizuara, duke u bazuar në identifikimin e ngushticave potenciale të performancës. Ekspert i certifikuar do të krijojë gjithashtu sisteme të avancuara raportimi dhe monitorimi, që do të ndihmojnë në gjurmimin e performancës së moduleve të reja dhe të platformës në tërësi. Përveç përpunimit të modeleve dhe optimizimit të infrastrukturës së të dhënave, eksperti do të:

- Intervistojë kategoritë e përdoruesve që do të përdorin sistemin;
 - Analizojë bazën ligjore dhe rregulloret që disponon Autoriteti Kontraktor, për të siguruar pajtueshmërisë me rregulloret dhe standardet që lidhen me menaxhimin dhe privatësinë e të dhënave (*përfshirë sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet për mbrojtjen e të dhënave, politikat e ruajtjes së të dhënave dhe rregulloret e tjera që lidhen me menaxhimin e të dhënave*).
- d. një profesionist të certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit.

Argumentim: Kërkesa për të angazhuar një profesionist të certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit është përcaktuar në përputhje me Vendimin Nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore’”. Profesionisti, ndër të tjera, do të sigurojë që të gjitha të dhënat personale dhe financiare të përdoruesve të ruhen dhe të përpunohen në mënyrë të sigurt, duke përfshirë enkriptimin dhe autentifikimin e duhur. Gjithashtu, profesionisti i certifikuar për sigurinë do të integrojë modulet e reja në platformën ekzistuese pa kompromentuar sigurinë e sistemeve dhe do të sigurojë që të gjitha pikat e hyrjes janë të mbrojtura. Kjo kërkesë ofron garanci për Autoritetin Kontraktor (AK) se OE është i aftë të identifikojë dhe adresojë problemet e mundshme të sigurisë që mund të rezultojnë në humbje të të dhënave. Certifikimi për sigurinë e sistemeve të informacionit dëshmon se punonjësi është i kualifikuar për të hartuar dhe zbatuar politika të ndryshme të sigurisë, përfshirë politikat e aksesit të të dhënave, politikat e kontrollit të versionit dhe politikat e mirëmbajtjes së të dhënave. Gjithashtu, ai/ajo do të krijojë dhe implementojë politika të sigurisë së informacionit, duke siguruar që aplikacioni të jetë i mbrojtur ndaj sulmeve të mundshme.

Duke qenë se platforma dhe modulet e reja janë web-based, është thelbësore të implementohen teknikat më të avancuara të sigurisë për të minimizuar rreziqet. Kjo qasje gjithëpërfshirëse e sigurisë, që përfshin të gjitha nivelet e sistemit – nga infrastruktura teknike te politikat operacionale – zvogëlon në masë të madhe rreziqet e shkeljeve dhe humbjes së të dhënave, duke mbrojtur kështu të dhënat dhe reputacionin e institucionit.

- e. dy punonjës të certifikuar si specialist të zgjidhjes Windows Server 2016 ose ekuivalente.

Argumentim: Specialistët e certifikuar në Windows Server 2016 ose ekuivalent dëshmojnë njohuri të thella mbi sistemin operativ dhe mjedisin në të cilin do të funksionojë platforma ekzistuese, duke siguruar që modulet e reja të integrohen në mënyrë të përshtatshme dhe të

jenë të kompatibël me sistemin ekzistues. Përveç kësaj, specialistët me njohuri të certifikuar do të jenë të aftë të optimizojnë performancën e serverit dhe të sigurojnë përdorimin efikas të resurseve, që do të jetë veçanërisht i rëndësishëm për modulet që do të menaxhojnë abonimet, rezidentët dhe taksitë, të cilat mund të kenë kërkesa të larta për performancë. Zhvillimi dhe instalimi i moduleve shtesë mund të kërkojë ndryshime të konsiderueshme në konfigurimin e serverit dhe në administrimin e bazës së të dhënave, dhe punonjësit e certifikuar në Windows Server 2016 ose ekuivalent do të ndihmojnë në zhvillimin dhe implementimin e këtyre moduleve në mënyrë të sigurt dhe efektive. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e serverëve do të jetë gjithashtu shumë e rëndësishme për platformën e Tirana Parking. Specialistët do të mund të identifikojnë dhe të adresojnë problemet potenciale para se ato të shkaktojnë ndërprerje të shërbimit, duke siguruar funksionimin e pandërprerë të sistemit.

f. një punonjës të certifikuar si auditues i sistemeve të informacionit.

Argumentim: Në fazën e integritit dhe testimit të moduleve të shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taksi, si dhe gjatë periudhës 24-mujore të mirëmbajtjes, operatori ekonomik fitues do të duhet të testojë dhe auditojë sistemin e ngritur, të njohë në detaje strukturën e tij dhe të propozojë përmirësime teknike të brendshme, përveç mirëmbajtjes së përgjithshme të sistemit. Për të garantuar funksionalitetin e moduleve, arkitekturën e instalimit dhe gjurmimin e veprimeve gjatë fazave të zhvillimit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit, është e domosdoshme që audituesi i sistemeve të informacionit, i punësuar pranë operatorit ekonomik, të vlerësojë kushtet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes së aplikacionit për të siguruar që aplikacioni të jetë i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Audituesi do të kryejë kontrole të herëpashershme gjatë proceseve të zhvillimit të softuerit për të siguruar që të gjitha kërkesat dhe specifikimet e sigurisë së informacionit ndjekin standardet dhe politikat e përshtatshme të sigurisë. Gjithashtu, audituesi do të vlerësojë funksionalitetin e sistemit për përdoruesin fundor (end-user), do të implementojë strategji auditimi për sistemin bazuar në menaxhimin e rrezikut dhe në zbatim të raporteve të auditimit të kryera gjatë ngritjes, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit. Para marrjes në dorëzim të moduleve të sistemit nga përfituesi, audituesi do të testojë dhe auditojë aplikacionin për të përcaktuar nëse rezultatet, kontrollet dhe kërkesat e projektit janë përmbushur.

g. një punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Argumentim: Kërkesa e Autoritetit Kontraktor (AK) që Operatori Ekonomik (OE) të dëshmojë që ka në përbërje të stafit një punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë është e lidhur ngushtë me objektivat që OE duhet të përmbushë gjatë periudhës 24-mujore të mirëmbajtjes. Angazhimi i një punonjësi të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve gjatë kësaj periudhe do të sigurojë AK-n që sistemet do të funksionojnë pa ndërprerje, duke monitoruar performancën dhe optimizuar burimet në mënyrë efektive. Gjatë periudhës së mirëmbajtjes, mund të shfaqen çështje teknike që kërkojnë njohuri të avancuara për t'u zgjidhur. Një punonjës i certifikuar është i aftë të adresojë këto çështje shpejt dhe në mënyrë efektive. Përveç kësaj, ai mund të ofrojë mbështetje teknike dhe udhëzime për përdoruesit, duke përmirësuar përvojën e tyre dhe duke

ndihmuar në zgjidhjen e problemeve që mund të hasin. Gjithashtu, kërkesat për shërbimet mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe mund të kërkohej rritje e kapacitetit. Një specialist i çertifikuar është i aftë të menaxhojë këto ndryshime në mënyrë efikase, duke siguruar që shërbimet të përmbushin nevojat e përdoruesve pa ndërprerje, të qëndrueshme dhe efikase gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa çertifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e kritereve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Çertifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vëndi i origjinës, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.
- CV e secilit punonjës.
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Argumentim: Kërkesa për staf sipas kërkesave të kriterit 2.3.3 është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4, ku citohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe

profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Fushat e përmendura të kualifikimeve sipas kërkesave të kriterit 2.3.3 janë pjesë e fushave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, sikurse është dhe i fokusuar tërësisht projekti objekt prokurimi. Punonjësit e specializuar në këto fusha dëshmojnë kanë njohuri dhe ekspertizë teknike, aftësi për të përdorur teknologjitë e reja dhe për të sjellë inovacion në implementimin e platformës, të cilat janë të rëndësishme për ndërtimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informatik. Përgjithësisht, kjo kërkesë për punonjës të çertifikuar në risistë teknologjike ka për qëllim sigurimin e një ekipi me njohuri të thella dhe aftësi të specializuara për të siguruar suksesin e implementimit të platformës dhe për të përmirësuar performancën dhe sigurinë e saj në të ardhmen. Me numrin e kërkuar të ekspertëve/profesionistëve synohet të garantohet realizimi i bërjes aktiv të shërbimit brenda

afateve kohore të specifikuar në termat e referencës së kësaj procedure si dhe realizimi i shërbimit të vazhdueshëm të mirëmbajtjes, ku është e domosdoshme të parashikohen dhe rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (*leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj*).

Afati i kryerjes së shërbimit:

4 (katër) muaj për implementimin e platformës dhe

24 (njëzet e katër) muaj mirëmbajtja e sistemit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.